

TECHNICAL DATA SHEET

ALTAKOLL C2TES1 GRI / BARDHE


PERSHKRIMI

Ngjitës pllakash me bazë çimento, i cilësisë së lartë, i formuluar me rëra karbonati dhe mermeri të përzgjedhura, rezina sintetike dhe aditivë speciale që sigurojnë forcë ngjitëse të përmirësuar, fleksibilitet të lartë dhe performancë të qëndrueshme në aplikime profesionale. Falë formulës së tij të avancuar, produkti ofron punueshmëri të shkëlqyer, aplikim të lehtë, rezistencë ndaj rrëshqitjes vertikale dhe kohë punueshmerie të zgjatur, duke mundësuar ngjitje më të saktë dhe korrigjim më të lehtë gjatë aplikimit.

Karakterizohet nga rezistencë e lartë ndaj lagështisë, fortësi e njëtrajtshme pas tharjes dhe fleksibilitet i përmirësuar, duke e bërë të përshtatshëm për sipërfaqe që kërkojnë qëndrueshmëri më të lartë dhe siguri afatgjatë në aplikim.

Mund të aplikohet në shtresa me trashësi deri në 15 mm.

I klasifikuar si ngjitës C2TES1 sipas standardit EN 12004: ngjitës me baze çimento me forcë ngjitëse të përmirësuar, rezistent ndaj rrëshqitjes, me kohë punueshmerie të zgjatur dhe deformueshmëri/-fleksibilitet të klasës S1.



PËRFITIME DHE KARAKTERISTIKA

1. Ngjitje e shkëlqyer
2. Punueshmëri shumë e mirë dhe aplikim i lehtë
3. Pa rrëshqitje vertikale
4. Kohë punueshmerie e zgjatur
5. Fleksibilitet / deformueshmëri S1
6. Rezistencë e lartë ndaj lagështisë
7. I përshtatshëm për pllaka me format të madh
8. Për ambiente të brendshme dhe të jashtme
9. I rekomandueshëm për fasada, tarraca, ballkone dhe ambjente me ngrohje qendrore
10. Aplikim në trashësi deri në 15 mm

FUSHA E APLIKIMIT

I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave qeramike, gres-porcelanit, klinkerit, mermerit, pllakave prej guri, mozaikëve, si dhe pllakave me absorbim të ulët dhe me trashësi të lartë, mbi suporte të qëndrueshme me bazë çimento.

Produkti rekomandohet për aplikime profesionale në tualete, ballkone, tarraca, fasada dhe ambiente me prani lagështie, si dhe për sipërfaqe me ngrohje qendrore. Falë ngjitjes së përmirësuar, fleksibilitetit S1, kohës së punueshmerie të zgjatur dhe rezistencës ndaj rrëshqitjes vertikale, siguron vendosje të saktë, të qëndrueshme, të sigurt, në sipërfaqe vertikale dhe sfiduese.

Mund të përdoret mbi suporte të qëndrueshme me bazë çimento, si llaçra çimentoze, shtresa niveleuese dhe dysheme të maturuara mirë. Është i përshtatshëm për pllaka me absorbim të ulët, pllaka me trashësi dhe format të madh, me dimensione nga 5 cm deri në 120 cm, në varësi të suportit dhe kushteve të aplikimit.

MENYRA E PËRGATITJES SE PËRZIERJES

Hidhni 7–8 litra ujë të pastër në një enë të pastër dhe shtoni gradualisht 25 kg Altakoll, duke e përzier me mikser elektrik me xhiro të ulëta derisa të përftohet një masë homogjene, kremoze dhe pa kokrriza.

Lëreni përzierjen të pushojë për rreth 10 minuta, në mënyrë që aditivët të aktivizohen plotësisht, dhe më pas përziejëni përsëri përpara përdorimit.

Përzierja e përgatitur ruan punueshmërinë për rreth 2–3 orë në kushte normale temperature, afërsisht 20°C. Gjatë aplikimit, rekomandohet që materiali të përzihet herë pas here pa shtuar ujë, për të ruajtur konsistencën dhe performancën optimale.

TECHNICAL DATA SHEET**ALTAKOLL C2TES1 GRI / BARDHE****PËRGATITJA E SUPORTIT**

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vakra dhe jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Përafer-sisht dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhen të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike. Përpa-ra aplikimit të produktit, sipërfaqja e suportit duhet të spërkatet me ujë në mënyrë që produkti të krijojë një ngjitje sa më të mirë dhe të ketë një kohë punueshmërie sa më optimale.

APLIKIMI

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërn-darje sa më të njëtrajtshme dhe më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përshtatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosija e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke u siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqjen me kollë. Koha e hapjes së produktit në kushte atmosferike normale është 35 minuta për temperatura 23°C. Kushtet atmosferike mund të ndikojnë në kohën e tharjes së produktit. Duhet pasur kujdes që kolla nuk duhet të formojë sipërfaqje filmi. Në të kundërt atëherë është e nevojshme që të kalohet dhe një herë malla mbi kollë. Nuk këshillohet që pllakat të vendosen me fuga të puthitura. Pllakat vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme me dimensionet e tyre. Në sipërfaqjet e bashkimit me muret vertikale duhet lënë një distancë prej 5 mm.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg
Ngjyra:	E bardhë/Gri
Konsumi:	2-3 kg/m ²
Konsumi per formate te medha:	4-5 kg/m ²
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e Magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Masa Vëllimore:	1.5 – 1.6 gr/cm ³
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa E
Ujë për përzierje:	7-8 litra ujë për 25 kg
pH i përzierjes:	13
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Koha e korigjimit:	35 min
Mbushja e fugave në mure:	Pas 8 deri 12 orësh
Mbushja e fugave në dysheme:	Pas 24 orësh

TECHNICAL DATA SHEET**ALTAKOLL C2TES1 GRI / BARDHE****TË DHËNAT TEKNIKE**

Forca e ngjitjes pas 28 ditësh:	$\geq 1 \text{ N/mm}^2$
FN pas zhytjes në ujë:	$\geq 1 \text{ N/mm}^2$
FN pas reaksionit nga ngrohja:	$\geq 1 \text{ N/mm}^2$
FN pas cikleve ngrirje-shkrirje:	$\geq 1 \text{ N/mm}^2$
FN pas 30 min:	$\geq 0.5 \text{ N/mm}^2$
I shkelshëm:	Pas 24 orësh
Rreshkitshmeria:	$\leq 0.5 \text{ mm}$